



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1073/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Liridon Dula kandidatë për anëtar për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Liridon Dula kandidatë për anëtar për Kuvendin Komunal në Gjakovë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas Shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 16.11.2017 në ora 11:45, ka pranuar një apel përmes postës nga Liridon Dula kandidatë për anëtar për Kuvendin Komunal në Gjakovë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me të cilin pretendon se në vendvotimet në fshatrat: Mulliq, Hereq dhe Babaj, atij i mungojnë votat e disa personave të cilët e kanë votuar.

Parashtruesi i apelit ne apelin e tij si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa personave në cilësinë e votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ne apel të apeluesit gjeti se, apeluesi nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e tij ne apel, në lidhje me mungesën e votave, pasi që në apel nuk ka cekur numrin e vendvotimeve e po ashtu as numrin e votave për të cilat pretendon se i kanë humbur. Prandaj, Paneli apelin e apeluesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i apeluesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.1073/2017 me datën 16.11.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*